

VENDIM
Nr. 355, datë 16.6.2021

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “SHITESË E IMPIANTIT TË PËRPUNIMIT TË UJIT TË PIJSHËM BOVILLË, ME 1 800 l/sek, NË FAZËN E DYTË TË ZBATIMIT, ME 1 200 l/sek”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Shtesë e impiantit të përpunimit të ujit të pijshëm Bovillë, me 1 800 l/sek, në fazën e dytë të zbatimit, me 1 200 l/sek”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë sh.a.

3. Pronarët të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 11 056 007.60 (njëmbëdhjetë milionë e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtatë pikë gjashtëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 11 056 007.60 (njëmbëdhjetë milionë e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtatë pikë gjashtëdhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2021 të Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë sh.a.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2021 të Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë sh.a.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë sh.a.

8. Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë – Vorë, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a., të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuar, në favor të Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë sh.a.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë – Vorë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë sh.a.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë – Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “SHITESË E IMPIANTIT TË PËRPUNIMIT TË UJIT TË PIJSHËM BOVILLË, ME 1 800 l/sec, NË FAZËN E DYTË TË ZBATIMIT, ME 1 200 l/sec”

Nr	Pronari			Të dhënat mbi pasurinë sipas ASHK-së				Vlerësimet për shpronësim sipas llojit të pasurisë						Vlera totale (lekë)	Shënime
								Shpronësim tokë "truall"			Shpronësim ndërtesë banimi (shtëpi)				
	Emër	Atësia	Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale e truallit (m²)	Sip. e truallit të prekur (m²)	Çmimi i truallit lek/m²	Vlera e truallit në lekë	Sip. e ndërtesës së prekur (m²)	Çmimi obj. lek/m²	Vlera në lekë		
1	Shkëlzen	Nikoll	Beka	1066	59/20	truall	211.8	161.80	3,560	576,008	70.60	32,113	2,267,177.80	2,843,185.80	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kamzë Vorë
2	Shkëlzen dhe Sugare		Beka	1066	59/26	truall	366.6	366.60	3,560	1,305,096	122.20	32,113	3,924,208.60	5,229,304.60	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kamzë Vorë
3	Mirash	Fran	Pjetri	1066	59/27	truall	118.9	118.90	3,560	423,284	76.40	32,113	2,453,433.20	2,876,717.20	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kamzë Vorë
4	Ylber dhe Pashkë		Mrishaj	1066	59/29	truall	500	30.00	3,560	106,800	-			106,800.00	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kamzë Vorë
Vlera totale								677.30		2,411,188	269.20		8,644,819.60	11,056,007.60	

1. Për tokën “truall”, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, datë 3.2.2016.